



Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen  
tonë dhe vendin ku jetojmë!

Rrethanat dhe mjedisi  
ndikojnë mbi ne, por  
ne jemi përgjegjës për  
vetveten.

Paulo Coelho

*Në këtë buletin do të gjeni:*

**Rritja e kapaciteteve për menaxhimin e kimikateve**

Vlerësimi gjendjes në mjedis

Faqe 2

**Situata nga pluhurat (PM10) në Vlorë dhe Berat**

Faqe 3

**Databaza për masat administrative**

Partneriteti AKM – Agjencia Europiane e Mjedisit

Faqe 2

**Shqyrtimi për vlerësimin e ndikimit në mjedis**

Sesioni i 69-të i UNECE për ekonominë qarkulluese

Faqe 4

**Monitorimi i Basenit të Ishmit**

**Edukimi mjedisor në shkolla**

Faqe 5

## Rritja e kapaciteteve për menaxhimin e kimikateve

Në kuadër të projektit “Rritja e kapaciteteve teknike në kuadër të menaxhimit të kimikateve në Shqipëri” me partner zbatues Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Specialistët e sektorit të kimikateve kanë qënë të pranishëm në takimet e përjavshme, në kuadër të rritjes së kapaciteteve teknike, me pjesëmarrjen e specialistëve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, specialistëve të Agjencisë Suedeze të Kimikateve, KEMI, SIDA.

Në këto takime fokusi është dhënia e ekspertizës suedeze në plotësimin e kërkesave të zbatimit të ligjit nr.207/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, me objektiva :

- Krijimin e regjistrit kombëtar të kimikateve
- Plotësimin e funksionit “helpdesk” nga sektori i kimikateve
- Dhënie e ekspertizës në hartimin e legjislacionit shqiptar plotësues në fushën e kimikateve
- Hartimin e praktikave inspektuese në fushën e kimikateve
- Kryerjen e trajnimeve me të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e legjislacionit shqiptar në fushën e kimikateve.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi është gritur grupi ndërinstitucional i punës në fushën e kimikateve, duke plotësuar nenin 7 të ligjit nr.207/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”.

Në datën 17 Mars 2021 është organizuar takimi i parë on line i grupit të punës, ku u prezantuan objektivat e projektit dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2021.



Të pranishmit prezantuan situatën e përgjithshme të institucionit që përfaqësonin në lidhje me menaxhimin e kimikateve dhe legjislacionin përkatës ku operonin.

Për plotësimin e funksionit “helpdesk”, është krijuar adresa elektronike [info.kimikatet@akm.gov.al](mailto:info.kimikatet@akm.gov.al) për informimim e palëve të interesuara në lidhje me kimikatet dhe zbatimin e Ligjit Nr 27/2016.

Gjithashtu në kuadër të forcimit të kapaciteteve sektori i kimikateve ishte pjesëmarrës në takimin e organizuar nga UNEP dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me titull “Forcimi i kapaciteteve në lidhje me menaxhimin e mbetjeve farmaceutike në Shqipëri”.

Në faqen zyrtare të AKM-së, [www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al) është publikuar lista e substancave kandidate të miratuara, me Vendim nr. 222 datë 07.04.2021, si dhe informacione shtesë në lidhje me ligjin e menaxhimit të kimikateve.

## Vlerësimi i Gjendjes në Mjedis

Vlerësimi i gjendjes në mjedis realizohet nëpërmjet monitorimit të treguesve të ndryshëm të mjedisit dhe paraqitet në Raportin e Gjendjes në Mjedis, i cili është një dokument që përgatitet çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Ky raport informon dhe njeh publikun mbi gjendjen e treguesve mjedisore, tendencën e tyre në vite si dhe ndihmon politikëbërësit dhe sektorët ekonomik të ndërmarrin veprime për të mbrojtur dhe menaxhuar mjedisin. Për përgatitjen e Raportit të Gjendjes në Mjedis për vitin 2020, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka bashkëpunuar me institucione të ndryshme si dhe ka organizuar takime me bashkitë e vendit për sigurimin e informacioneve sa më gjithëpërfshirëse mbi gjendjen e mjedisit.



### Pse është i rëndësishëm vlerësimi i gjendjes në mjedis ?

Vlerësimi i gjendjes në mjedis tregon lidhjet shkak-pasojë të veprimit njerëzor dhe natyror në mjedis . Rezultati përfundimtar duhet të jetë më shumë se sa të njohësh gjendjen e mjedisit.

Ai duhet t'u japë politikëbërësve dhe palëve të tjera të interesit udhëzime apo rekomandime se si të menaxhojnë më mirë mjedisin

Qëllimi kryesor i vlerësimit mjedisor është që të kuptohen pasojat ose ndikimet në mjedis dhe të identifikojë mënyrat për të minimizuar ndikimet negative dhe të përmirësojë mjedisin. Të sigurojë informacione për vendimmarrësit dhe të inkurajojë të gjithë palët e interesuara që vazhdimisht të pyesin nëse po bëhet mjaftueshëm me:

- Zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis të aktivitetit njerëzor ( biznese, individe, komunitete, industri etj) dhe natyror (ngrohja globale, klima, erozioni etj)
- Ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes së mjedisit

### Sfidat drejt procesit të vlerësimit të gjendjes në mjedis

Njohja e gjendjes së mjedisit dhe ndërveprimeve njerëzore si dhe ndikimet që ato kanë mbi njëri-tjetrin.

Përfshirja e rekomandimeve që dalin gjatë procesit të vlerësimit mjedisor në planifikimin e politikave mjedisore dhe mundësitë ekzistuese për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm.

Zhvillimi i masave të përshtatshme për të vlerësuar dhe minimizuar presionet në mjedis si dhe në përmirësimin e situatës mjedisore.

## Databaza për masat administrative

Bazuar në VKM Nr. 568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, në përgjegjësitë funksionale të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit u përfshi inspektimi dhe kontrolli tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

Sa më sipër AKM, ju nënshtrua procesit të ristrukturimit dhe me Urdhrin Nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” në strukturën e institucionit u shtua Drejtoria e Inspektim-Kontrollit, dhe Sektori i Ankimimeve (apelim, ekzekutim, trajtim i penaliteteve) si një sektor i ri pranë kësaj drejtorie

Detyrat funksionale të Sektorit të Ankimimeve janë:


- Menaxhon dhe shqyrton ankimimet për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve në kuader të aplikimit të përgjegjësisë mjedisore dhe ndëshkimit të shkeljeve të legjislacionit mjedisor dhe dëmtimit të mjedisit;
- Ndjek procesin e ekzekutimit të detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura me qëllim arkëtimin e shumave në favor të institucionit;
- Bashkëpunon me sektorët, drejtoritë dhe Agjencitë Rajonale, lidhur me zbatimin e praktikave më të mira ligjore dhe zbatimin e drejtë të legjislacionit mjedisor;
- Menaxhon databazën e kundërvajtjeve administrative;
- Miraton metodikën apo parime të tjera shtesë, mbi të cilat mbështetet sektori mbi përcaktimin e vlerës së gjobës, për rastet e kundërvajtjeve, për të cilat parashikohet i njëjti dënim.

Në zbatim të Urdhrit Nr. 181, datë 21.12.2020 “Për krijimin e databazës për masat administrative, proceset gjyqësore/përmbartimore deri tek likuidimi i gjobës” të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së, Sektori i Ankimimeve në bashkëpunim me Degët Rajonale të AKM-së po ndërton databazën për masat administrative si dhe ndjekjen e procesit të ekzekutimit të detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura.

REGJISTRI I KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE PËR MJEDISIN VITI 2021						
Kolaja e kryes	Numri dhe data e vendimit të dënimin administrativ	Numri serial i gjobës	Vlera e gjobës 000/leke	Ankimuar në ISHIMP	Gjohë e shqyrtuar nga Komisioni i Ankimimeve Nr. Vendimi data dhe lenë në fuqi ose jo	Gjohë në proces gjyqësor

## Partneriteti AKM – Agjencia Europiane e Mjedisit

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka vijuar punën për përmushjen e angazhimeve të Shqipërisë drejt Agjencisë Europiane të Mjedisit. Qendrat Kombëtare të Referencës, të nominuar për të raportuar të dhëna dhe informacione mjedisore mbi tregues mjedisor të përcaktuar nga EEA, janë angazhuar në këtë proces duke mundësuar raportimin e tyre në kohë dhe cilësinë e duhur. Kështu, gjatë kësaj periudhe janë raportuar të dhënat e cilësisë së ujërave bregdetare larës, cilësisë së ujërave të ëmbla, sasitë e ujërave në rang kombëtar, PRTR, Zonat e Mbrojtura dhe Biodiversiteti etj. Ekspertët shqiptarë, pjesë e Rrjetit Europian të Informacionit dhe Vëzhgimit Mjedisor kanë marrë pjesë në takimet e seminarit online të zhvilluara gjatë kësaj kohe, duke qenë pjesë aktive e proceseve informuese dhe formuese e duke ndjekur në vazhdimësi procesin e asistencës dhe ngritjes e forcimit të kapaciteteve, nën kujdesin dhe mbështetjen e EEA, mundësuar nga instrumenti IPA II.




Agjencia Europiane e Mjedisit në bashkëpunim të ngushtë me vendet e Ballkanit Perëndimor, ka ndjekur proceset e lidhura me zbatimin e Dokumentit Kuadër të KE, mbi Programin e Punës për Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe me aktivitete konkrete, të ndara sipas fushave, të cilat janë në linjë me Marrëveshjen e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, për periudhën 2021- 2027, e cila ka filluar implementimin e saj nga 1 Janari 2021.

Ky dokument synon krijimin e një bashkëpunimi më të fortë dhe efektiv, në mbështetje të vëndeve përfituese të IPA III, si dhe përbushjen e objektivit kryesor të përcaktuar nga Komisioni Europian atë të Forcimit drejt proceseve integruese dhe perspektivës europiane për vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe përgatitjen e tyre e drejt përbushjes së kërkesave dhe detyrimeve për anëtarësim.

Në linjë me objektivat zhvillimore e strategjike të përcaktuara, ka filluar puna në disa drejtime e tematika mjedisore për ngritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve raportuese e monitoruese, të organizuara në formën e mini projekteve për disa komponentë mbi të cilat po punohet në bashkëpunim të ngushtë me EEA. Ato janë

- 1- Mbetjet dhe politikat e menaxhimit të tyre
- 2- Biodiversiteti / Natura 2000 / Rrjeti Emerald
- 3- Studimet mbi pritshmëritë mjedisore në kuadrin e përgatitjes së RGJM
- 4- Studim dhe analizë mbi sektorin e ujërave dhe përdorimin e tyre në Shqipëri
- 5- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve monitoruese të cilësisë së ajrit

Modernizimi i strukturave të EIONET – EEA, si në nivel evropian ashtu edhe në nivel kombëtar, ka qënë një nga angazhimet dhe përfshirjet më intensive të muajve të fundit, ku Shqipëria merr pjesë në tre grupe pune të ngritura paralelisht me fokus tek dizenjimi dhe implementimi i strukturës së ardhshme e EIONET/EEA, propozimi i paketës së re të NRC-ve si dhe rishikimi dhe hartimi i listës së re të dhënave kryesore të Eionet. Pas katër muajve pune intensive ka një produkt i cili ka hyrë në faze konsultimi.



Rrjeti Kombëtar EIONET, Shqipëria ka marrë pjesë dhe kontribuar në gjithë proceset e sipër përmendura, duke shënuar një pjesëmarrje aktive dhe angazhim serioz. Numërohen mbi 30 takime online të organizuar vetëm gjatë kësaj periudhe me tematika të ndryshme sipas fushave.

Për herë të parë vjen në Shqipëri për gjithë partnerët dhe aktorët shqipëtarë në fushën e mjedisit, Strategjia e EEA- EIONET 2021-2030 mbi objektivat e punës dhe parimet strategjike të punës së EEA për vitet në vijim.



Për më shumë mbi EEA-EIONET klikoni në: <https://www.eea.europa.eu/about-us/eea-eionet-strategy-2021-2030-1>

### Situata nga pluhurat (PM10) në Vlorë dhe Berat

Grimcat e pluhurit (PM) janë një përzierje e aerosoleve (të ngurta ose të lëngëta) që përfshijn një diapason të gjerë në madhësi dhe kompozime kimike

PM10 (PM2.5) i referohet grimcave me diametër 10 (2.5) micrometër ose më të vogël, dhe emërtohet direkt në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, NH<sub>3</sub> dhe NMVOC. Grimcat e pluhurit emetohen nga shumë burime antropogjenike si djegja e lëndës djegëse, ndërtime, pluhuri natyral pezull, kripa e detit etj.


PM mund të shkaktojë dhe përkeqësojë sëmundjet e zemrës dhe mushkërive, goditje në zemër dhe aritmi. PM mund të dëmtojë sistemin nervor qendror, sistemin prodhues dhe mund të shkaktojë kancer. Një nga rezultatet e ekspozimit të PM mund të shkaktojë vdekje të parakohshme.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka realizuar monitorimin e grimcave të pluhurit PM10 në qytetin e Vlorës dhe Beratit me pajisjen Tecora, me metodën gravimetrike dhe të dhënat janë llogaritur ditore.

Tecora është instaluar në terracën e Bashkisë Vlorë. Bashkia Vlorë është pranë rrugës Spiro Gjijnuri ku duhet të theksojmë që është një rrugë me trafik.


Numri i makinave që lëviz në këtë rrugë është i lartë gjatë gjithë ditës.

Vlerat ditore të PM10 për periudhën 02.04.2021-17.04.2021 në qytetin e Vlorës



Nga rezultatet e monitorimit vihet re se kemi tejkalim të normës ditore 2 ditë nga 16 ditë të monitoruar. Vlera më e lartë është monitoruar me datën 06.04.2021 dhe është 95.52 µg/m<sup>3</sup> ndërsa vlera më e ulët me datën 04.04.2021 dhe është 13.86 µg/m<sup>3</sup>.

Vlerat ditore të PM10 për periudhën 02.04.2021-17.04.2021 në qytetin e Beratit.



Nga rezultatet e monitorimit vihet re se nuk kemi tejkalim të normës ditore në asnjë nga 16 ditët e monitoruara. Ky rezultat i ulët i PM10 vjen si pasojë e mosqarkullimit të makinave pranë pikës ku ne kemi instaluar pajisjen e monitorimit.

## Shqyrtimi për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Agjencia Kombëtare e Mjedisit merr në shqyrtim dhe nxjerr vendimin për projektet që kanë ndikim në mjedis gjatë fazës së ndërtimit. Qëllimi kryesor i këtij procesi, është të sigurojë:

- një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Për periudhën Janar-Prill, 2021, janë marrë në shqyrtim dhe janë dhënë vendime për 350 projekte. Pjesën më të madhe të aplikimeve e zënë projektet infrastrukturore, të enteve publike dhe private.

✚ Ndër projektet publike mund të përmendim:

- Rikonstruksione rrugësh, urash, ujesjella
- Projektet e rindërtimit nga fatkeqësia natyrore e tërmetit Nëntor, 2019
- Ngritje institucionesh arsimore dhe shëndetësore
- Blloqe banimi për familjet e pastreha


✚ Ndër projektet private përmendim:

- Projektet në fushën e bujqësisë
- Projektet në fushën e turizmi dhe agroturizmit

E gjithë procedura është ndjekur në zbatim të:

- Ligjit 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar
- Ligjit Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”

Vlerësimi i projektit përfshin, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara, të cilat përfshihen në kushtet që vendosen në Vendimin e lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.



### Sesioni i 69-të i UNECE për ekonominë qarkulluese

Rajoni i UNECE udhëheq botën në prodhimin, shtimin e vlerës dhe transformimin e burimeve të saj natyrore për konsum socio-ekonomik. Këto burime janë drejt përfundimit, ku rritja e prodhimit dhe konsumi i tyre kërkon energji të mëdha dhe burime të tjera, të cilat çojnë në degradim mjedisor dhe rritje të cenueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike - efekte që janë të komplikuar në popullatat gjithnjë e më të urbanizuara të rajonit.

Kalimi në një ekonomi qarkulluese dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore është thelbësore për arritjen e Qëllimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goal).

Për sa më sipër në datat 20-21 Prill u mbajt Sesioni i 69-të i UNECE, me pjesëmarrje të ministrave dhe zëvendësministrave si dhe nga institucionet përkatëse ku Vendi ynë ishte prezent me përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Ky takim u siguroi vendeve një mundësi si:

- Shkëmbimi i përvojave për kalimin në një ekonomi cirkulare (qarkulluese) dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore
- Identifikimi i boshllëqeve dhe mënyrat për t'i adresuar ato
- Histori të suksesit përmes webinarëve dhe ekspozitave të dedikuara

## Monitorimi i basenit të Ishmit

Agjencia Kombëtare e Mjedisit me asistencë të projektit “Mbeshtetje e Bashkimit Europian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri” (EUSIWM), i cili zbatohet nga ADA (Austrian Development Agency), ka realizuar kampionimin në terren për përcaktimin e nutrientëve dhe makroinvertebrorëve në 22 stacione në gjithë basenin e Ishmit.



Gjatë kampionimit janë realizuar matje in-situ të parametrave të mëposhtëm në çdo stacion:

- pH
- Temperatura e ujit
- Oksigjeni i tretur

Kampionimi është realizuar konform metodave standarte ISO dhe në përputhje me kërkesat e ISO 17025: 2017 “Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues”. Qëllimi i këtij projekti është vlerësimi i cilësisë së ujërave në basen nëpërmjet përcaktimit të statusit kimik dhe vlerësimit biologjik sipas Direktivës Kuadër të Ujit

## Edukimi mjedisor në shkolla

Agjencia Kombëtare e Mjedisit me mbështetjen e projektit të GIZ “Menaxhimi i Modernizuar i Mbetjeve të Ngurta dhe Ekonomia Ricikluese në Respekt të Mjedisit” gjatë periudhës Janar- Mars 2021 ka zhvilluar orë edukative mjedisore në disa shkolla 9- vjeçare të vendit tonë për menaxhimin e mbetjeve



Qëllimi kryesor është informimi i fëmijëve në lidhje me ndarjen e mbetjeve sipas rrymave, hedhjen e rregullt të mbetjeve në vendet e caktuara nga bashkia.



Sensibilizimin e tyre për reduktimin e përdorimit të artikujve njëpërdorimshe të plastikës si dhe riciklimin e ripërdorimit të tyre. Gjatë këtyre orëve janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese ku nxënësit e shkollave kanë paraqitur vizatime, poster dhe punime të realizuara me materiale të riciklueshme



